

Aktivitetet per muajt Nentor 2008 – Maj 2009

Fokusi kryesor i punes ka konsistuar ne:

A) Implementimin e pese projekteve:

1. PMB (projekti i kujdesit shendetesor paresor)
2. PST (projekti i te semureve terminale)
3. Jete e Cmueshme – Cmueshem Jetoj
4. Fuqizimi i pergjigjes kombetare ndaj HIV/AIDS
5. Projekti i dergimit te pacienteve ne Itali.

B) Aktiviteti i Koordinimit te Qendrave Shendetesore

1. Takime koordinimi me pergjegjeset dhe zv/pergjegjeset dioqezane te shendetesise.
2. Vizita ne Qendrat Shendetesore te Caritas-it

A) Implementimi i pese projekteve

1. PMB

Ne kuader te implementimit te ketij projekti eshte ne perfundim e siper mbyllja e etapes se dyte te 41 mini projekte nga 37 qendra shendetesore te Caritas Shqiptar te filluara ne qershor te 2008. Synimi kryesor i ketyre mini projekteve ka qene perm isimi i cilesise se jetes permes sensibilizimit dhe edukimit shendetesor te komunitetit.

Krahas edukimit te komunitetit kemi vazhduar edhe me organizimin e takimeve te trajnimit per operatoret e shendetesise te mbajtur prane ambienteve te Universitetit Katolik “Zoja e Keshillit te Mire”.

Per periudhen Nentor 2008- Maj 2009, jane zhvilluar tre takime. Me konkeretisht:

Takimi i pare eshte mbajtur ne Nentor dhe ne fokus ka patur etiken ne shendetesi si dhe komitetet etike. Ka qene nje teme e nje specifike te vecante duke patur parasysh kushtet dhe nivelin e shendetesise ne vend. Pjesemarresit e kane ndjekur me shume interes.

Takimi i dyte eshte mbajtur ne Mars dhe ka patur si teme Planifikimin Familjar si dhe Observatorin e Varferise.

Takimi i trete eshte mbajtur ne fillim te Majit dhe ka patur si teme Aspektin Shendetesor te HIV/AIDS si dhe Adresimin e Rasteve.

2. PST

Eshte vazhduar puna ne tre qendrat ne Shkoder, Lezhe dhe Elbasan. Jane mbuluar me sherbim paliativ 140 persona .

Eshte monitoruar puna ne dy qendra deri tani dhe raporti i punes se deritainishme ka qene pozitiv duke na inkurajuar te vazhdojme te punojme me perkushtim per kete shteresë te popullates qe nuk perfiton nga kujdesi shendetesor shteteror (ende nuk eksistojne struktura shteterore te posacme per te semuret terminale).

3. Jete e Cmueshme – Cmueshem Jetoj

Per sa i perket ketij projekti ka perfunduar studimi mbi gjendjen social- shendetesore te 150 personave me aftesi te kufizuar (PAK), ne distriktet Shkoder, Lac dhe Kruje dhe eshte bere perzgjedhja e 45 PAK, perfitues te asistences social- shendetesore .

Ne muajin Shkurt dhe Mars jane zhvilluar pese trajnime qe kishin ne fokus semundjet nervore pergjegjese per paaftesine fizike dhe mendore si dhe perqasja sociale ndaj problemeve te lidhura ngushte me personat me aftesi te kufizuar. Me konkretisht:

Organizimi i *konferences* me teme: “Prezantimi i studimit mbi gjendjen social-shendetesore te PAK ne qytetet Shkoder, Lac dhe Fushe – Kruje”. Konferenca u zhvillua ne date 18 Shkurt paren Universitetit „Zoja e Keshillit te Mire“.

Organizimi i *takimit formativ* per PKSHP me teme: “Pajisja e personelit shendetesor me njohurite baze mbi patologji neurologjike qe shkaktojne paaftesine“. Takimi formativ u zhvillua ne date 26 Shkurt.

Takimit formativ per punonjes te sektorit shendetesor dhe social me teme: “Njohurite baze mbi Autizmin dhe Paaftesine Intelektuale“. Takimi formativ eshte zhvilluar ne date 3 Mars.

Takimi informativ “Aspekti Social i personave me aftesi te kufizuar”

Takim permbledhes rreth punes se bere deri ne Mars nga ekipet ne Shkoder, Lac dhe Fush-Kruje.

Tani vazhdon puna ne terren me tre ekipe multidisiplinare ne Shkoder, Lac dhe Fushe-Kruje.

4 Fuqizimi i pergjigjes kombetare ndaj HIV/AIDS

Ne kuader te ketij projekti jane zhvilluarkater *trajnime* ne nivel teorik dhe praktik ne datat 3, 5, 7 dhe 10 Shkurt. Kane perfituar nga keto trajnime 71 infermiere te qendrave shendetesore te Tiranes.

Zhvillimi i *Workshop* me teme: “Permiresimi i kushteve te implementimit te Strategjise Kombetare ndaj HIV/AIDS ne grupet vulnerabel”. Workshop u organizua ne date 9 shkurt prane Hotel Mondial. Pjesemarres perfaqesues te organizatave per HIV/AIDS.

Perpos trajnimit te personelit shendetesor te Tiranes, eshte trajnuar personel shendetesor i mesem ne Shkoder dhe Lac pergjate muajve Mars – Prill.

5 Dergimi i pacienteve ne Itali.

Projekti ka filluar ne fund te 2008. Ka konstatuar ne dergimin e femijeve me kardiopati kongenitale. Pacientet jane perzgjedhur nga nje ekip kardiopediatresh nga Potenza. Ky ekip vizitoi Caritasin ne Prill dhe per kater dite jane vizituar me shume se 70 femije dhe neonate me probleme kardiake.

Gjithashtu kemi arritur nje marreveshje me AUSL te Regio Emilia te cilet jane te gatshem te kurojne paciente shqiptare me kusht qe Caritasi regional perkates te jete i perfshire.

B) Aktiviteti i Koordinimit te Qendrave Shendetesore

1 – Takime koordinimi me pergjegjeset dhe zv/pergjegjeset dioqezane te shendetesise.

Sektori shendetesor ne Caritas ka organizuar per harkun kohor Nentor - Maj tre takime me pergjegjeset dhe zv/pergjegjeset te Caritaseve Dioqesane per te arritur nje koordinim sa me te mire te punes. Datat e takimeve kane qene:

Ceshtjet per te cilat eshte folur permendim:

- Edukimi shendetesor i komunitetit ne drejtim te parandalimit te semundjeve dhe mbrojtjes se shendetit
- Ana financiare e mbarevajtjes se mini projekteve te lidhura me PMB si dhe te PST.
- Lejet e ushtrimit te aktivitetve shendetesore nga Autoritetet Lokale Shendetesore
- Planifikimi i trajnimeve kombetare
- Furnizimi me medikamente dhe materiale njekesore te infermierive dhe qendrave shendetesore
- Personeli shendetesor ne qendra dhe bashkepunetoret e tyre
- Rishikimi i rregulloreve rreth hapjes dhe mbylljes se qendrave shendetesore
- Statistikat
- Etj.

2 – Vizita ne Qendrat Shendetesore te Caritas-it

Nje hallke shume e rendesishme e punes sone jane edhe vizitat ne qendrat shendetesore te Caritasit. Jane pikerisht keto vizita qe sherbejne per te mbajtur kontakte te vazhdueshme me qendrat tona, per te marre informacionet e domosdoshme rreth aktiviteteve apo zgjidhjen e paqartesive te mundshme qe mund te dalin gjate punes. Keto vizita jane edhe nje menyre mjaft efikase per te bere monitorimin e punes. Pjesa me e madhe e qendrave jane vizituar deri tani.

Konkluzion

Cdo vit, ne vazhdojme te kuptojme se ne mes te gjitha ndryshimeve, vazhdon te qendroje nevoja per operimin e qendrave shendetesore te Caritas-it.

Ne pjesen me te madhe te qendrave, edukimi shendetesor si dhe sherbimi shendetesor mbeten prioritare ne fushen e kujdesit shendetesor paresor.

Per 2008 numri i perfitueseve te drejteperdrejte nga miniprojektet ishte 5300, 180 nga trajnimet ne nivel kombetar dhe 55.337 paciente perfituan nga sherbimet shendetesore te ofruara nga qendrat shendetesore te Caritas-it, 152 paciente termianle kane perfituar nga kura palliative dhe 45 persona me te aftesi te kufizuar jane perfshire ne projektin e ri “Jete e cmueshme – Cmueshem jetoj”.

Ne vazhdojme t’i perkushtohemi me te varferve nder te varfer dhe personave qe jetojne ne zona te thella dhe te marginalizuara.

Si Sektor Shendetesor ne jemi prezente qe t’i ofrojme ndihmen tone cdo personi ne nevoje si dhe te japim nje shembull etike ne cdo aspekt te punes me qellim arritjen e nje kujdesi shendetesor efektiv dhe te aksesueshem.

Gjithashtu ne qendrojme te hapur per bashkeveprime te metejshme ne fushen e shendetit me autoritet shtetore dhe organizatat joqeveritare.

Ne jemi te kenaqur te raportojme se puna ne Departamentin Shendetesor vazhdon te jape praktiken me te mire ne nje game te gjere fushash qe i perkasin Sherbimit Paresor ne vend.

Takimet tona te rregullta ne nivel kombetar dhe lokal me Koordinatorët Shendetesore te Dioqezave perkatese, na ndihmojne per te patur nje vizion sa me te qarte per te ardhmen.

Gjithashtu, bashkepunimi ne te gjitha nivelet, eshte i rendesishem per te ardhmen tone per te arritur rezultatet me te mira ne vazhdimesine e dhenies se praktikes me te mire nga Sektori Shendetesor i Caritas-it Shqiptar ne fushat e Sherbimit Paresor ne Shqiperi.